

# LETËR PËR HAPJEN E SHKOLLES

Në letër për mbajtjen në dijeni të prindërve dhe nxënësve që ndikohen nga mbyllja, zhvendosja dhe shkrimi e shkollave, për ditën e parë të fillimit të shkollës!



## Drejtoria dhe Partnerët e Qytetit punojnë për mbajtjen e rrugëve të sigurta për nxënësit

Në bashkëpunim me Qytetin e Filadelfias, organizata "Town Watch Integrated Services (TWIS)", një organizatë e përkushtuar për bërjen e Filadelfias një vend të sigurtë për punë dhe jetesë, ka bashkuar një grup partnerësh të gatshëm për rritjen e sigurisë së rrugëve ku kalojnë nxënësit për në shkollë, për vitin e ardhshëm shkollor.

"WalkSafePHL" do të mbështesë prindërit dhe banorët e komunitetit në përcaktimin e rrugës ku do të udhëtojnë nxënësit për në shkollë, duke ofruar trajnime dhe paisje. Vullnetarë të rritur do të bëjnë monitorimin e rrugës gjatë vitit shkollor, duke ndihmuar që nxënësit të arrijnë të sigurtë në destinacionin e tyre.

Zyra e Shkollave të Sigurta (Office of School Safety) e Drejtorisë Arsimore ka punuar nga afër me "TWIS" për angazhimin e familjeve dhe komunitetit me programin "WalkSafePHL" gjatë muajve të verës. "Zyra jonë është e përkushtuar për një mjedis të sigurtë për nxënësit," është shprehur Chief Dorsey, Kryeinspektor për Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, "dhe krijimi i koridoreve të sigurtë është një hap kryesor drejt këtij qëllimi."

Në shtesë të "TWIS", partnerë të Programit të Koridoreve të Sigurtë, përfshijnë "Bicycle Coalition, BuildON, EducationWorks, the Mayor's Office of Civic Engagement and Volunteer Service, the Mayor's Office of

Education, the Philadelphia Police Department, the PhillyRising Collaborative, the Office of Public Safety, the School District of Philadelphia dhe SEPTA Police".

Prindërit dhe pjestarët e komunitetit të interesuar për t'u përfshirë në "WalkSafePHL", duhet të kontaktojnë Anthony Murphy me email në [Anthony.murphy@phila.gov](mailto:Anthony.murphy@phila.gov).

### Si po punojmë?

Një paraqitje e Progresit të Drejtorisë në përgatitjen e shkollave pritëse për vitin e ri shkollor:

#### Përqindja e ...

Përmirësimeve të përfunduara në ndërtesat e shkollave pritëse	68%
---	-----

Shkollave pritëse me Drejtor të konfirmuar për vitin e ardhshëm shkollor	98%
--	-----

#### Numri i ...

Shkollave pritëse me programimin e kohës jashtëshkollore (Out-of-School Time) për vitin e ardhshëm	20
--	----



## Vlerësimet dhe Regjistrimet Speciale për Nxënësit e Rinj Imigrantë do të fillojnë në Muajin Gusht

Zyra e Programeve dhe Kurikulës Shumëgjuhëshe do të ndihmojë fëmijët e ardhur rishtaz në USA që të plotësojnë procesin e regjistrimit me mbështetjen e duhur gjuhësore gjatë muajit Gusht.

Shërbimet do të ofrohen nga datat 5-30 Gusht në Qendrën e Vlerësimit Shumëgjuhësh të Drejtorisë (MAC) në adresën 440 North Broad Street, 1<sup>st</sup> Floor, Suite 1195. Personeli do të shoqërojë prindërit gjatë procesit të regjistrimit, testimit të fëmijëve për ESOL, si edhe do të ofrojë informacion për burimet dhe Drejtorinë Arsimore të Filadelfias.

Vitin e kaluar "MAC" asistoi dhe regjistroi mbi 800 nxënës që flisnin 40 gjuhë të ndryshme nga më shumë se 70 vende të botës.

Ju lutemi kontaktoni Qendrën e Vlerësimeve Shumëgjuhëshe në numrin 215-400-4240, dhe zgjidhni opsionin 1 për më shumë informacion dhe/ose planifikoni një takim.

**ÇFARE:** Asistencë familjeve imigrante në regjistrimin e fëmijëve të tyre

**KU:** 440 North Broad Street, 1<sup>st</sup> Floor, Suite 1195

**KUR:** 5 -30 Gusht 2013  
E Hënë- E Premte, 8:30am-6:00pm



## Numrat më të përdorshëm Telefonikë

PYETJE PER...	KONTAKTONI
<b>Mbështetje dhe Pasurim Mësimor</b> Ofron udhëzime profesionale për mësuesit në fushat e muzikës, artit, vallëzimit, theatrit, fizkulturës, aktivitetet jashtëshkollore, librit dhe gjuhëve të huaja	215-400-5902
<b>Frekuentimi dhe Mungesat</b> Ofron shërbime mbështetëse për shkollat, që të përmirësojnë frekuentimin dhe uljen e mungesave	215-400-4220
<b>Edukimi Tekniko Profesional</b> Ofron programe dhe shërbime për nxënësit e përfshirë në Edukimin tekniko Profesional	215-400-2331
<b>Fëmijëria e Herëshme</b> Ofron programe dhe shërbime për fëmijët e moshave 0-6 vjeç dhe familjet e tyre	215-400-4270
<b>Angazhimi i Familjes &amp; Komunitetit</b> Aftëson familjet dhe komunitetin për akses dhe përfshirje në programet dhe shërbimet e Drejtorisë	215-400-4180
<b>Edukimi Shumëgjuhësh</b> Ofron shërbime dhe mbështetje shumëgjuhësore për nxënësit dhe familjet	215-400-4240
<b>Caktimi i Nxënësit</b> Vlerëson kërkesat për transferim të nxënësit dhe përcakton shkollën e duhur	215-400-4290
<b>Rekordet e Nxënësit</b> Mban dhe proceson kërkesat për rekordet e nxënësve (transkripte, verifikime, kërkesa, rekordet e paafetësisë, etj.)	215-400-4780
<b>Shërbimet e Specializuara</b> Ofron shërbime të edukimit special, mbështetjes së specializuar dhe të shëndetit të nxënësit	215-400-4170
<b>Siguria e Shkollës</b> Angazhohet me administratorët e shkollës, policinë, nxënësit, prindërit dhe pjestarët e komunitetit, për rritjen e sigurisë të nxënësve në mjediset e shkollës dhe përreth saj.	215-400-4710
<b>Transporti</b> Ofron transport të sigurtë për nxënësit e Filadelfias, që ndjekin shkollat publike, private, charter, dhe ato fetare.	215-400-4350

## "United Way" jep \$50,000 për Tranzicionin

"United Way" e rajonit të Filadelfias dhe Jugut të Nju Xhersit (UWGPNJ) dhuroi \$50,000 për Drejtorinë Arsimore të Filadelfias javën e kalur, si ndihmë për nxënësit që u janë mbyllur shkollat, për një tranzicion sa më të lehtë në shkollat e reja këtë Shtator.

Granti, një bashkëpunim midis (UWGPNJ) dhe "Public Citizens for Children and Youth"(PCCY), do të mundësojë drejtorët e afro 40 shkollave për të zhvilluar programe integrimi me kosto të ulët, për prindërit dhe nxënësit në shkollat e reja.



## Regjistrimi i Përgjithshëm i Nxënësve fillon ditën e Hënë 19 Gusht

Regjistrimi do të hapet në shkollat e lagjes ditën e Hënë, 19 Gusht 2013. Orari i regjistrimit është si më poshtë:

E Hënë, E Martë, E Enjte dhe  
E Premte: 8 a.m. - 1 p.m.  
E Mërkurë: 11 a.m. - 4 p.m.

Prindërit mund të përdorin "School Finder" në websajtin e Drejtorisë Arsimore, për përcaktimin opsionit të shkollës fillore, tetëvjeçare dhe të mesme në zonën në të cilën banojnë:  
[www.philasd.org/schoolfinder](http://www.philasd.org/schoolfinder).

Prindërit duhet të rishikojnë listën e dokumenteve të kërkuara për regjistrim në websajtin e "School Opening", përpara se të paraqiten në shkollë për plotësimin e regjistrimit:  
[www.philasd.org/schoolopening](http://www.philasd.org/schoolopening).